



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:175880

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485150

P.nr. 376/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale ndaj të akuzuarës Sh. H., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.379/22 e datës 24.08.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 11.03.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarës Sh. H., si dhe të dëmtuarës A. S., me datë 12.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

Sh. H., nga i ati Rr., e ëma M., e vajzërisë H., e lindur me datë ..., në Mitrovicë, me vendbanim në rr. “...” - Mitrovicë, me numër personal ..., e papunë-amvise, ka të kryer dy vite të shkollës së mesme, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e pa dënuar.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE:

Me datë 10.02.2022, rreth orës 16:00, në Mitrovicë, në lagjen Shipol, në rrugën “...”, konkretisht në market ..., e pandehura me dashje dhe me fjalë serioze e kanos tani të dëmtuarën A. S. në atë mënyrë që, e *pandehura kishte shkuar disa herë në marketin ku e dëmtuara kishte qenë duke punuar dhe i kishte thënë ta tërheq aktakuzën ndaj vëllaut të pandehurës dhe nëse nuk e tërheq* ka me qenë keq, me çka e dëmtuara e ka ndier veten të frikësuar dhe të kanosur dhe është detyruar ta paraqes rastin në polici.

Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve:1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, lidhur me nenin 181 par. 1 të KPRK-së, dhe neneve:364, 365, 449, 452 dhe 460 të KPP-së, të akuzuarës, i:

S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400 € (*katërqind euro*), të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse e akuzuara nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t`ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo 20 € (njëzet euro) gjobë me një (1) ditë burgim.
- II. Obligohet e akuzuara që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.
- III. Pala e dëmtuar A. S., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.379/22 të datës 24.08.2023, kundër të akuzuarës Sh. H., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni, e akuzuara Sh. H., si dhe e dëmtuara A. S..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarës i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë e akuzuara lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas aktakuzës, dhe fillimisht i ka kërkuar falje gjykatës, prokurorisë dhe të dëmtuarës. E akuzuara tutje ka deklaruar se nuk ka dashtë me ndodh kjo ngjarje, mirëpo ka ndodh sepse në atë kohë nuk i ka menduar pasojat. Është pënduar thellë për këtë rast që ka ndodhur, është nënë e dy fëmijëve dhe i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla. Me të dëmtuarën A. janë pajtuar, nuk kanë asgjë të keqe mes vete dhe nuk do të kenë as në të ardhmen.

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës, gjykatës i ka propozuar që të njëjtën ta shpall fajtores për veprën e kryer penale, t'i shqiptoj një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të marrë pranimin e fajësisë nga e akuzuara, ndërsa si rrethanë rënduese të marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

E dëmtuara A. S., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës ka deklaruar se, e mbështet në tërësi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe kërkim faljen e saj, duke shtuar se ia fali Sh., janë pajtuar me njëra – tjetrën dhe tash kanë raporte të mira mes vete. Në atë kohë kur e ka lajmëruar rastin në polici ka qenë në depresion dhe e frikësuar sepse përndryshe nuk do ta kishte lajmëruar rastin dhe dëshiron që e akuzuara të mos dënohet dhe të jetë e qetë. Nuk kanë asgjë të keqe mes vete dhe nuk do të kenë as në të ardhmen. Gjithashtu e dëmtuara nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurorë juridike.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me nr. 2022-BC-133, i datës 10.02.2022, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarës/dëshmitares, i datës 10.02.2022, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dyshuarës tani të akuzuarës Sh. H., i datës 10.02.2022, Deklarata e të dëmtuarës e dhënë në prokurori më datë 17.08.2023, si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në mënyrë vullnetare, se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke e njoftuar të akuzuarën se pas pranimit të fajësisë, ajo nuk mund të bëjë ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e akuzuara.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarës dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se e akuzuara Sh. H. ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri në 6 (gjashtë) muaj.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga e akuzuara në seancën e shqyrtimit fillestar, si rrethana lehtësuese gjeti keqardhjen e shprehur dhe pendimin e thellë për veprën e kryer duke i kërkuar falje para gjykatës të dëmtuarës, faktin se me të dëmtuarën i kanë rregulluar raportet, si dhe faktin se sipas verifikimeve në evidencën penale të kësaj gjykate me Nr.736/2024 të datës 12.03.2024, e akuzuara nuk ka qenë asnjëherë më parë e dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm. Ndërsa, rrethana rënduese në rastin konkret nuk gjeti.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryeses, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryeses. Po ashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par.2 nën par 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 460 të KPP-së, kjo pasi që e dëmtuara në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se heqë dorë nga kjo e drejtë.

Nga sa u tha më lartë, konform nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal
P.nr.376/2023, datë: 21.03.2024

Zyrtari ligjor:
Besart Mustafa

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.